



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Tiranë, më 18.03.2026

NJOFTIM

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR TË MARRË PJESË NË  
TRYEZËN E DISKUTIMIT DHE KËSHILLIMIT TË PLATFORMËS SË  
PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EVROPIAN KAPITULLIN 18 -  
STATISTIKAT**

Në mbështetje të VKM nr.749, datë 19.12.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", Urdhrit të Kryeministrit Nr. 94, datë 20.5.2019 "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për Integrimin Evropian" si dhe të Urdhërit të Kryeministrit Nr.113, Datë 30.08.2019, për "Format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për integrimin Evropian", ju ftojmë të bëheni antarë në diskutimet dhe këshillimet e Tryezës së Diskutimit dhe Këshillimit të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian për **Kapitullin 18 - Statistikat**.

Qëllimi kryesor i kësaj Tryeze të Diskutimit dhe Këshillimit të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, është të diskutojë, të shqyrtojë dhe të ndërmarrë qëndrime dhe rekomandime drejtuar Sekretariatit të Integrimit Evropian e strukturave të tjera përgjegjëse në procesin e integrimit evropian, për çështjet e Statistikave.

Të gjithë anëtarët e strukturave jo-shtetërore, që duan të jenë pjesë e diskutimeve dhe këshillimeve të kësaj Tryeze të Diskutimit dhe Këshillimit të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, duhet të përfaqësojnë një nga grupimet e mëposhtme:

- ✓ Organizatat e shoqërisë civile,
- ✓ Pushteti vendor,
- ✓ Komuniteti i biznesit,
- ✓ Shoqata e punëmarrësve,
- ✓ Bota akademike, qendrat kërkimore,
- ✓ Media,
- ✓ Grupe të tjera interesi.

Të gjithë anëtarët e strukturave jo-shtetërore, ftohen të dërgojnë brenda 30 ditëve nga shpallja e institucionit përgjegjës për kryesimin e kapitullit, formularin e plotësuar të aplikimit, ku të përcaktohet qartë përvoja, si dhe interesi për të qenë pjesë e Tryezës së Diskutimit dhe Këshillimit të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, në adresat e postës elektronike: [vsimoni@instat.gov.al](mailto:vsimoni@instat.gov.al); [xhalbrahimi@instat.gov.al](mailto:xhalbrahimi@instat.gov.al);

Personat e përzgjedhur dhe ata të skualifikuar, së bashku me arsyet e skualifikimit, do të njoftohen përmes adresës së postës elektronike brenda datës 20.04.2026.

**Kryetari i Tryezës së Diskutimit dhe Këshillimit të Platformës së Partneritetit për  
Integrimin Evropian për Kapitullin 18 Statistikat**

**Lantona Sado**



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vilazen Huta, Nd.35, H.1 Njesia Administrative Nr.2, 1017. Tirane.

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)